

MUHAMET MALA**BALLKANI NË PROJEKTET ANTIOSMANE TE FUQIVE
EVROPIANE GJATË SHEKULLIT XVII**

Tradita e bashkimit në luftë dhe e organizimit politik të popujve ballkanikë kundër Perandorisë Osmane, nuk kishte shpëtuar pa u vërejtur nga fuqitë evropiane. Këto fuqi në konflikt me osmanët në plan të parë llogaritin forcën konkrete të ballkanasve si mënyrë për t'i larguar osmanët nga Evropa Juglindore. Pamundësia e ndonjë organizimi të popujve ballkanikë në qendra urbane në shek. XVII diktoi forcimin e unitetit dhe organizimit politik në zonat malore, ku ndikimi osman ishte i paktë. Në këto zona organizimi politik u shpreh në formën e kuvendeve¹. Në rrethana të okupimit kuvendet u bënë forma më e lartë e organizimit politik nga të cilat doli një bërthamë e kancelarisë shtetërore që përcillte shkresa dhe memorialë të pajisur me vula në të cilën shprehej karakteri shtetëror dhe institucional i popujve të ndryshëm ballkanikë. Disa nga popujt ballkanikë e filluan që t'i përdorin këto vula si shprehje shtetësie, siç vërehet në një vulë ku përreth shqiponjës ishin shkruar fjalët "Mbretëria e Maqedonisë dhe e Shqipërisë"². Pa marrë parasysh faktin se autenticiteti dhe zyrtarizmi i këtyre vulave mund të jetë çështje diskutimi, prapëseprapë ideja e tillë është domethënëse, sepse shtronte një segment të rëndësishëm të organizimit shtetëror dhe të përfaqësimit të jashtëm, i cili pretendonte të krijohet. Organizimet politike të shqiptarëve iu ofruan shteteve evropiane që kërkonin që këto lëvizje t'i përdornin si anekse të planeve të tyre luftarake, por shpeshherë kur lidhej paqja me Perandorinë Osmane shqiptarët mbetnin në mëshirën e ekspeditave hakmarrëse osmane që mes tjerash i jepte kah procesit të islamizimit të shqiptarëve. Koha e organizimit të kuvendeve shqiptare njëherësh është koha e tron-

¹ Kuvend = bisedë, kuvendi nënkuptonte tubimin ku mblidheshin përfaqësuesit e zgjedhur të fisit, apo të krahinës dhe ku bisedoheshin çështje me rëndësi, të cilat kishin të bënin me krahinën, fisin apo më gjerë.

² *Dokumente të shek. XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, vëll. II (1593-1602), përgatiti për botim Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë: 1990; Horvat, *Glasnik XXI*, dok. nr. 40, f. 34-35.

ditjeve, e baticave dhe e zbaticave në vetë skenën politike e fetare evropiane. Evropën e krishterë e kishte kapluar kriza e protestantizmit. Autoriteti papal ishte lëkundur, kështu që pas vitit 1603 veprimi i papës në Evropë ishte kufizuar, sidomos në disa nga provincat gjermane dhe pjesët veriore të Evropës. Kësisoj, iniciativa antiosmane kaloi për një kohë në duart e spanjollëve për ta vazhduar më vonë Perandoria Habsburge. Në të vërtetë, Austria gjatë shekullit XVII ende nuk kishte arritur të lirohej nga presioni osman. Ajo ishte interesuar të përkrahte popullsinë e Ballkanit në luftë kundër Perandorisë Osmane, por nuk kishte forcë të mjaftuar, nga ana tjetër ishte edhe vetë e rrezikuar. Derisa Austria të konsolidojë pozitën e vet përballë osmanëve, do të kalojë pothuajse një shekull dhe, gjatë kësaj kohe, përpjekjet austriake konsistonin në nxitjen e kryengritjeve pa ndonjë ndihmë ose pjesëmarrje konkrete. Në anën tjetër, Spanja që qëndronte më fuqishëm në idetë e veta politike ushqente aspirata pushtuese si kundër Turqisë ashtu edhe kundër Venedikut. Spanja shfaqte interes të njëjtë si për Kotorrin ashtu edhe për Tivarin dhe Ulqinin. Madje, më 1606 Durrësi sulmohet nga spanjollët. Ushtarët nga anijet u futën në qytet duke plaçkitur dhe duke i hequr topat nga muret për t'i ngarkuar më pastaj në anije. Gjatë tërheqjes ata ia vunë zjarrin qytetit³.

Është evident fakti se në përpjekjet e tyre për t'iu afruar fuqive evropiane religjioni i krishterë i malësorëve shqiptarë shikohej si element lehtësues dhe njëherësh bënte që osmanët të shikohen jo vetëm si armiq të vendit, por edhe si armiq të fesë. Si rrjedhim, në kuvende kemi pjesëmarrjen edhe të krerëve fetarë, veçanërisht të kishës katolike që pretendonin ndërhyrjen e fuqive të krishtera evropiane. Në të vërtetë, ata u bënë ndërlidhësit diplomatikë të kuvendeve shqiptare. Disfata osmane në Lepant e kishte rritur shpresën se po të bashkoheshin fuqitë e krishtera, Turqia mund të detyrohej të largohej nga Ballkani. Gjatë dekadës së fundit të shek. XVI, fuqitë evropiane, me gjithë antagonizmat që kishin, filluan të përgatiteshin për luftë, kështu që më 1592 Austria dhe Perandoria Osmane filluan luftimet midis tyre. Papati dëshironte që të fillonte realizimin e planeve të veta antiosmane pikërisht nga Ballkani. Si pikënisje e veprimeve konsideroheshin Hercegovina, Shqipëria dhe

³ *Dokumente të shek. XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, vëll. III (1603-1621), Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë: 1989, dok. nr. 19, f. 63-65.

Mali i Zi. Shqipëria konsiderohej e rëndësishme për faktin se në Itali jetonin një numër i madh shqiptarësh, të cilët ishin të gatshëm të vihen në shërbim të Papatit. Po ashtu, një numër i madh shqiptarësh, të ikur nga Ulqini e Tivari, me rastin e pushtimit të qytetit nga osmanët, ishin strehuar në territoret venedikase dhe ishin të gatshëm të ktheheshin me armë në dorë.

Në qershor të vitit 1593 në Shqipëri u mor vesh formimi i koalicionit evropian kundër Turqisë. Kjo klimë antiosmane bëri që, më 7 qershor 1594, në Manastirin e Shën Mërisë në Mat të mbledheshin kuvendi i përgjithshëm i Shqipërisë⁴. Në kuvend morën pjesë edhe përkrahësit e marrëveshjes me Republikën e Venedikut, edhe pse kjo nuk e donte luftën me Turqinë. Kuvendi ngarkoi kalorësit Tomë Plezha dhe Mark Gjini që, së bashku me peshkopin Nikollë Mekshi, të hyjnë në bisedime me papën për zbatimin e projektit të kryengritjes⁵. Kalorësi Plezha, më 3 shkurt 1595, i dha njoftim papës për kuvendin e krerëve shqiptarë si dhe planin e kryengritjes kundër pushtuesve osmanë. Ky kalorës, në raportin relativisht të gjatë, përmend traditat luftarake të shqiptarëve dhe nevojën për t'u furnizuar me armë. Ai parashikonte se nëse në Shqipëri do të fillonte kryengritja, sulltani do të braktiste ekspeditën në Hungari ose do t'i ndante forcat e veta dhe do të rrezikohej të humbiste, sepse megjithëse ushtria e tij ishte e shumtë, nuk do të kishte sasi të madhe ushtarësh të mirë dhe kështu të krishterëve do t'u bëhej më e lehtë çdo ndërmarrje kundër tij⁶.

Më 1596 përfaqësuesit shqiptarë i përsëritën në Romë kërkesat për armë duke potencuar sërish faktin se po të kishin armë kryengritësit shqiptarë do të bënin diversion të madh në forcat turke, në mënyrë që hungarezët dhe austriakët të kishin mundësi të bënin përparime të mëdha. Duke u organizuar në planin e brendshëm dhe duke dashur që para Fuqive të Mëdha të paraqiten sa më unikë, në fund të vitit 1601 u mbledh kuvendi i përgjithshëm shqiptar në fshatin Dukagjin të Matit para kishës së Shën Lleshdrit, i cili vazhdoi punimet edhe në fillim të vitit 1602. Në kuvend morën pjesë delegatët e ardhur nga 14 krahina të Shqipërisë. Kuvendi u drejtua nga Nikollë Mekshaj, Nikollë Bardhi dhe Gjin Gjergji. Kuvendi mori vendimin për fillimin e luftës për çlirimin e Shqipërisë, i

⁴ N. Ukëgjini, *Albanci katolici u sjevernoj Albaniji i u današnjoj Crnoj Gori za vreme turskog gospodstva (XV-XX)*, Zagreb: 2002, f. 43.

⁵ *Dokumente të shek. XV-XVII...*, vëll. II, f. 27; Horvat, *Glasnik XXI*, dok. 26, f. 23-25.

⁶ Po aty.

cili u nënshkrua nga 56 krerë kryesorë, katër nga secila krahinë. Në vendim thuhej se morën pjesë 2565 delegatë⁷. Kuvendi vendosi që të niste për në Venedik dy përfaqësues të vet, të cilët kishin për detyrë t'i deklarorin senatit të Shën Markut se, nëse nuk ndihmohej lëvizja e armatosur, atëherë ata do t'i drejtoheshin një fuqie tjetër, duke aluduar për Spanjën. Kur Austria lidhi paqe me Turqinë, atëherë Venediku u përpoq ta ruante edhe më tej raportin miqësor me Portën e Lartë dhe, në këtë mënyrë, nuk i mbështeti kërkesat e shqiptarëve.

Vlen të theksohet se pothuajse tërë projektuesit e luftës antiosmane në Ballkan e shihnin mundësinë e ndarjes së forcave osmane në dy fronte, duke lehtësuar veprimin kundër saj. Kësisoj, një projekt i datës 5 dhjetor 1606, me autor Anton Kaboga* parashihte shmangien e forcave osmane nga fronti i Hungarisë, duke i vënë në veprim forcat kryengritëse në Ballkan. Në këtë projekt, kryengritja në Ballkan duhej t'i jepte një ndihmë të çmuar shtetit të Hungarisë pa shpenzuar tepër⁸. Duke dashur të pengonte organizimin dhe veprimin politik të shqiptarëve të pjesës veriore të Shqipërisë, Perandoria Osmane ndërmori një aksion të gjerë gjatë vitit 1610 në territorin që përfshinte Sanxhaku i Dukagjinit. Rruga që lidhte Shkodrën me Prizrenin dhe që kalonte nëpër këtë Sanxhak ishte vazhdimisht e pasigurt dhe në fillimin e çdo kryengritjeje ajo bëhej e pakalueshme. Duke qenë e çliruar nga luftërat me Austrinë dhe Hungarinë, Perandoria Osmane filloi ekspeditën ushtarake. Ajo arriti që ta ushtrojë kontrollin e vet në fshatrat që gjendeshin përgjatë rrugës. Në këtë rast, Dukagjini filloi të humbasë rëndësinë si vatër kryengritëse. Epiqendra u zhvendos në krahinat malore në veri të Shkodrës, si në Kastrat, Shkrel, Hot, Kelmend si dhe në ato që gjendeshin në Malin e Zi të sotëm si Piperi, Kuçi, Vasojeviqi, Palabardhi etj.

Me ekspeditat në Malësi të Madhe, osmanët nuk dolën fitimtarë, përkundrazi rezistenca e suksesshme shqiptare nxiti formimin e unitetit ndërmjet popujve të Ballkanit për bashkimin e forcave për luftë të përbashkët. Kësisoj, në Kuç të Malësisë së Madhe u organizua një kuvend i jashtëzakonshëm për të përgatitur një kryengritje të gjerë, ku u

⁷ *Dokumente të shek. XVI-XVII...*, vëll. II, dok. nr. 186, f. 271-275.

* Në bazë të mbiemrit Anton Kaboga duhej të ishte nga një familje e vjetër raguzane që edhe më herët kishte nxjerrë diplomatë të dalluar.

⁸ *Dokumente të shek. XVI-XVII...*, vëll. III, dok. nr. 30, f. 86. Kjo letër drejtuar zëvendësmbretit të Napolit për Mbretërinë e Spanjës i bie në dorë përfaqësuesit venedikas në Napoli, i cili për këtë informon senatin.

ftuan të merrnin pjesë, jo vetëm përfaqësues nga Shqipëria, por edhe nga Mali i Zi, Maqedonia e Serbia. Kuvendi u hap më 8 korrik 1614, ku u shtrua çështja e armëve dhe e ndihmave të tjera. Dokumentet e kohës na japin listën emërore të 44 krerëve shqiptarë dhe të kombësive të tjera që morën pjesë në kuvend⁹. Hollësitë mbi zhvillimet e punimeve të projektit për çlirim, të diskutuara në kuvend, na i jep dokumenti i përfaqësimit i kapedanit shqiptar Gjon Renesi, i dërguar i veçantë i kuvendit pranë Dukës së Parmës¹⁰.

Shqiptarët dhe të tjerët, duke e parë qëndrimin shpërfillës të Papatit, Venedikut e Spanjës, vendosën t'i drejtohen Dukës së Parmës në Itali dhe, nëse ky nuk do të pranonte t'i ndihmonte ata, atëherë do t'iu drejtoheshin shteteve protestante. Orientimin ndaj shteteve protestante, sidomos ndaj Anglisë dhe princërve gjermanë, kuvendarët mendonin ta përdornin si presion për t'i shtyrë fuqitë katolike t'i mbështesnin ata nga frika e përhapjes së protestantizmit në Ballkan. Politika e sabotimit nga ana e venedikasve edhe këtë herë dha rezultate. Ndihamat e dërguara nga Duka i Parmës u konfiskuan nga Venediku. Duke e parë zhvillimin e tillë të ngjarjeve, më 8 shtator 1614 u mbledhën sërisht në Kuç një kuvend i dytë për të shqyrtuar mundësitë e furnizimit me armë si dhe forcimin e lidhjeve me vendet e tjera të Ballkanit. Për këtë qëllim në këtë kuvend morën pjesë përfaqësues të krerëve të Malit të Zi, të Bosnjë-Hercegovinës, të Serbisë, të Maqedonisë, të Bullgarisë dhe të Dalmacisë¹¹.

Plani i veprimit ishte gjithëpërfshirës dhe nënkuptonte furnizimin me armë të malësorëve të Malit të Zi, të Dukagjinit dhe të Himarës. Pra, edhe pse kuvendet mbaheshin në pjesën veriore të Shqipërisë, jugu shqiptar nuk ishte lënë anash. Nga Himara ishte paraparë që 8 300 burra të çlironin kalanë dhe qytetin e Vlorës. Nga ana tjetër, dukagjinasi do ta merrnin me lehtësi Krujën, duke e parë se osmanët e kishin lënë pas dore rindërtimin e një pjese të murit të rrënuar. Të tjerët do të shkonin në Shkodër dhe Kasternovo*, ku ishin marrë vesh me rojat e natës, që ishin të krishterë, për të ndihmuar në marrjen e kështjellës. Kuvendi vendosi që ta dërgonte Gjon Renesin në Francë për t'u marrë vesh me Dukën e Neverës, i cili po përgatiste një ekspeditë për të zbarkuar në Ballkan.

⁹ *Dokumente të shek. XVI-XVII...*, vëll. III, dok. nr. 188, f. 289-298. J. Tomić, *Sastanak i dogovor srpskih glavara u Kučima 1614.godine*, Beograd: 1901, f. 86.

¹⁰ *Dokumente të shek. XVI-XVII...*, vëll. III, dok. nr. 188, f. 289-298.

¹¹ *Po aty*, dok. nr. 189, f. 301.

* Hercegnovi i sotëm në Mal të Zi.

Mirëpo, edhe këtë herë, për shkaqe organizative dhe mospajtimeve të fuqive të jashtme, ndihma e kërkuar nuk erdhi.

Mosrealizimi i projekteve të parashtruara nuk i dekurajoi përpjekjet që sërish të bëhej diçka në këtë drejtim. Kështu, më 11 nëntor 1616, në Prokupë të Serbisë, u mbledh sërish një kuvend ballkanik, ku u përpunua dhe u diskutuan më tej plani për çlirimin e vendit nga pushtimi osman. Në kuvend morën pjesë delegatë nga Bosnja, Kosova, Serbia, Shqipëria, Bullgaria, Maqedonia dhe Hercegovina¹². Këtë vit në Romë shkoi edhe prelati dhe shkencëtari shqiptar Pjetër Budi, i dërguar, siç thotë ai, nga popullsia e vendit të tij për të ngjallur interesimin e shteteve evropiane.

Përgatitjet e gjata të Dukës së Neverës dështuan plotësisht për shkak se flota iu dogj në pragun e nisjes për në ekspeditë. Nuk disponojmë dokumente që do të shënonin ndonjë fushatë ushtarake nga forcat e tjera në këto hapësira, megjithatë, sipas Korelevskit¹³, flitet për armë e municione që austriakët ua kishin dërguar himarjotëve. Ai gjithashtu shkruan për disa fitore të përkohshme në krahinën e Himarës me ndihmën e çetave austriake dhe venedikase, të cilat më vonë u tërhoqën, duke lënë bashkëpunëtorët e tyre shqiptarë nën mëshirën e hakmarjes turke. Kjo gjë, sipas tij, ishte aq e hidhur sa që, për t'u shpëtuar taksave, shumë prej këtyre njerëzve u bënë turq¹⁴.

Më 11 nëntor 1620 në Beograd u mbledh kuvendi i katërt ndërballkanik, por edhe kësaj radhe nuk u sigurua dot ndihma e nevojshme. Dështimi i ekspeditës së dukës së Neverës dhe shteteve të tjera për ta ndihmuar lëvizjen çlirimtare në Shqipëri, bëri që të angazhohet edhe ipeshkvi i lartpërmendur Pjetër Budi. Më 1621, kur po përgatitej që nga Roma të nisej për në Shqipëri, ai në një relacion të hollësishëm i drejtohet kardinalit Gocadino dhe kërkon vënien në jetë të projekteve që do ta mundësonin çlirimin nga Perandoria Osmane. Relacioni i Pjetër Budit është një dokument i rëndësishëm, në të cilin, përveç lajmeve, ekonomike, shoqërore e gjeografike, na jepet një pasqyrë e qartë mbi gjendjen politike të shqiptarëve pas 50 vjet kryengritjesh të vazhdueshme. Sipas Budit, koha më e përshtatshme për ekspeditë ishte

¹² *Dokumente të shek. XVI-XVII...*, vëll. III, dok. nr. 203, f. 344-348.

¹³ Korolevskij Cirillo, *Studi Orientali: La Missione greca Catolica della Cimara nel Epiro nei Secoli 16-18 në Bessarione*, Roma: 1911-1913, sipas Edwin Jacques, *Shqiptarët. Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*, Tiranë: Lajmi i mirë, (viti i botimit mungon), f. 274.

¹⁴ E. Jacques, *Shqiptarët. Historia e popullit shqiptar...*, f. 274.

viti 1621, sepse forcat osmane ishin angazhuar në luftë kundër Polonisë e vendi ishte pa ushtri turke. Kështu, sikur të bëhej kjo ekspeditë, atëherë do të fitonin zemër vetë polakët dhe perandori do t'i drejtonte armët kundër turqve¹⁵.

Refuzimet e vazhdueshme ndodhën edhe kësaj radhe sa që e revoltuan edhe vetë Pjetër Budin. Ai, me t'u kthyer në Shqipëri, mbledhi në një kuvend të posaçëm klerin katolik të tri dioqezave, Zadrimës, Shkodrës, Lezhës, të cilët i bindi të betoheshin që të mos pranonin asnjë peshkop të huaj në këto dioqeza dhe, nëse do të dërgohej ndonjë i tillë, atëherë të dëbohej me pretekst se nuk e njihte as gjuhën, as zakonet e vendit. Arsyeja ishte se peshkopët vepronin secili për interesa të shteteve me të cilat ishin të lidhura, duke e dëmtuar çështjen kryesore. Si duket, për shkak të përqendrimit të tij, pas dhjetë muajve, Pjetër Budi gjatë udhëtimit për në Malësi të Madhe, u mbyt nga armiqtë e tij kur po kalonte lumin Drin.

Mosangazhimi i duhur dhe i drejtë i fuqive evropiane në Ballkan bënte që përpjekjet e shqiptarëve për çlirim të përfundonin pa sukses dhe çdo dështim i kryengritjes shoqërohej me procesin e islamizimit. Prandaj, Vatikani, për ta ndërprerë këtë trend dhe për t'i forcuar pozitat e luhatura nga protestantizmi evropian, më 1622 themeloi kongregacionin e propagandës së fesë¹⁶. Në këtë rast fillon një konkurrencë edhe më e madhe mes Venedikut dhe Vatikanit për forcimin e pozitave në Ballkan. Në anën tjetër, negativisht ndikoi edhe fillimi i luftës tridhjetëvjeçare në Evropë, e cila përfundoi në vitin 1648 në Paqen e Vestfalisë. Kjo luftë, e pamundësoi përkohësisht angazhimin e Evropës në Ballkan.

Vatikani, në përpjekje për ta ushtruar sa më suksesshëm aktivitetin e vet në Ballkan, kërkonte njoftime paraprake mbi gjendjen ekzistuese të popujve nën sundimin e Perandorisë Osmane. Kësisoj, relacionet e Marin Bicit të vitit 1610¹⁷, Pjetër Mazrekut¹⁸ etj., ishin paralajmëruesit e angazhimit të Papatit në këto treva. Këto relacione janë të rëndësishme, mes tjerash, ngase japin edhe informacione mbi pozitën ekonomike, sociale, fetare e politike të Shqipërisë. Kështu, një relacion i Pjetër Mazrekut, argjipeshkëv i Tivarit, drejtuar kongregacionit të shenjtë të

¹⁵ *Dokumente të shek. XVI-XVII...*, vëll. III, dok. nr. 211, 15 shtator 1621, f. 376-387.

¹⁶ *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XVII*, vëll. I (1610-1634), përktheu dhe përgatiti për botim Injac Zamputi, Tiranë: 1963, f.

¹⁷ M. Bici, *Iskušnja na putu 1610 godine*, Cetinje: (pa vit botimi).

¹⁸ *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë...*, f. 429.

Propagandës Fide, pohon se “shpirtrat në Shqipëri po bien, jo aq nga tirania e turkut, sa nga mungesa e meshtarëve. Kombi shqiptar është më i mjeri e më i braktisuri nga të gjitha kombet që jetojnë në Evropë. Ndërsa gjermanët tedeshtë, hungarezët, grekët, ilirikët* e deri te turqit e hebrenjtë e kanë një vend pranë asaj selie, shqiptarët që, as për zell besimi, as për bindje e përkushtim ndaj të parit të kishës romake, nuk ua ka dalë asnjë komb tjetër, por vuajnë mjerisht dhe po bien për ditë, sepse janë pa shkolla e pa asnjë ndihmë shpirtërore”¹⁹.

Papati i dobësuar si nga autoriteti, si nga fuqia reale, politike, nuk pati mundësi inkuadrimi ushtarak në Ballkan. Megjithatë influenca e tij u shpreh në një aspekt tjetër po aq të rëndësishëm. Institucioni i Propagandës Fide u bë mjet i rëndësishëm, me anë të të cilit ndikohej tek priftërinjtë, duke u dhënë mundësi shkollimi dhe përgatitjeje fetare e diplomatike për t’u shndërruar më vonë në kuadro të jetës politike dhe shpirtërore. I tillë ishte rasti i udhëheqësve shqiptarë të fundit të shek. XVII dhe ideatorëve kryesorë të bashkëpunimit me austriakët, Pjetër Bogdanit dhe Toma Raspasarit.

Fillimi i shek. XVII me organizimin e kuvendeve dhe kryengritjeve, i kishte bërë zonat malore të Shqipërisë si epiqendra politike. Ndërsa në fund të shek. XVII, kjo epiqendër u bart në zonat fushore të Kosovës, për t’u udhëhequr e dirigjuar pikërisht nga priftërinjtë katolikë shqiptarë të ipeshkvisë së Prizrenit. Ipeshkvia e Prizrenit u rivendos në vitin 1618, kurse më 1656 i tërë rajoni i Kosovës kaloi nga juridiksioni i ipeshkvisë së Tivarit në atë të ipeshkvisë së porsafornuar të Shkupit. Shqiptari Andrea Bogdani u emërua argjipeshkëv i kësaj njësie kishtare. Kur ai dha dorëheqje më 1677, atë e trashëgoi nipi i tij Pjetër Bogdani nga fshati Hasi i Gurit²⁰, i cili do të bëhet protagonist kryesor i zhvillimeve politike shqiptare në Kosovë në fundin e shek. XVII dhe ideatori i bashkëpunimit me austriakët.

* Me këtë term relatori nënkupton sllavët e Dalmacisë – kroatët (M.M.).

¹⁹ *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë...*, f. 429.

²⁰ G. Gjini, *Skopsko prizrenska biskupija kroz stoljeća*, Zagreb: 1992, f. 117-118.

Luftërat e vazhdueshme të popujve ballkanikë kundër Perandorisë Osmane nuk kishin shpëtuar pa u vërejtur nga Fuqitë e Mëdha evropiane. Secila nga ato tentonte që t'i përdorte për interesat e veta organizimet politike që krijoheshin në Ballkan me qëllim çlirimi nga Perandoria Osmane. Në fundin e shek. XVI dhe fillimin e shek. XVII këto organizime politike që quheshin kuvende u konsoliduan në zona malore ku pushteti osman nuk ushtronte ndikim të drejtpërdrejtë. Mirëpo interesat e ndryshme të fuqive evropiane nuk lejuan që këto forca politike të korrnin sukses. Fuqitë evropiane kërkonin që këto lëvizje t'i përdornin si anekse të planeve të tyre luftarake. Shtetet si Papati, Venediku, Spanja dhe Austria i jepnin kahe të kundërta luftës antiosmane të popujve ballkanikë duke i detyruar të dështonin për shkak të interesave parcialiste. Dështimi i këtyre kryengritjeve dhe mospërkrahja parimore nga Evropa bëri që procesi i islamizimit të përhapet në një pjesë të Ballkanit duke e ndarë atë edhe më tepër nga Evropa e krishterë dhe duke e lidhur nga pikëpamja zhvillimore dhe kulturore me Orientin.

